



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1727/3 Prot

Tiranë, më 4 /11 /2021

VENDIM

Nr. 48, datë 4 . 11 .2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1727 Prot., datë 15.10.2021, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet e-mail-it datë 12.10.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, lidhur me:

- *Detyrimet e shlyera dhe të pa shlyera ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nga ana e kompanisë Bankers Petroleum që nga viti 2004.*

Autoriteti Publik nëpërmjet e-mail-it datë 12.10.2021, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...në zbatim të nenit 24 dhe 31 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet kujt i ofrohet informacioni mbi tatimpaguesin dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të tatimpaguesit. Neni 24 “Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga Administrata Tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat si: a) Gjyqtarit, b) Kontrollit të Lartë të Shtetit, c) Prokurorisë etj. Neni 31 “E drejta për konfidencialitetin e të dhënave të tatimpaguesit: 1- Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga Administrata Tatimore”.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, me shkresën nr. 1727/1 Prot., datë 19.10.2021, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 25.10.2021 me prezencën e ankueses dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik, znj.

, koordinatorë për të drejtën e informimit, znj. , me detyrë Specialiste Komunikimi.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, znj. , në cilësinë e personit përgjegjës, e cila deklaroi se ka hartuar përgjigjen e Autoritetit Publik, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në e-mail-in datë 12.10.2021.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoi përfaqësuesve të Autoritetit Publik për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur, brenda datës 27.10.2021, në përputhje me vendimet e marra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për çështje të ngjashme.

Në vijim, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it zyraeshtypit@tatime.gov.al, datë 27.10.2021, ka sqaruar se: *“Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në vijim edhe të seancës dëgjimore të zhvilluar ditën e hënë, data 25.10.2021, ora 11:00, është duke përgatitur një përgjigje për kërkuesen, znj. . Duke marrë në konsideratë, sipas objektit të kërkueses, tërësinë e dokumentit që po verifikohet dhe po përgatitet, ju bëjmë me dije se përgjigjen përfundimtare do t'ju vendosim në dispozicion edhe juve në ditët në vijim”*.

Brenda afatit të vendosur nga Zyra e Komisionerit, si dhe deri në datën e këtij vendimi, Autoriteti Publik nuk pati asnjë reagim mbi qëndrimin përfundimtar në lidhje me vënien ose jo në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Në këto kushte, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, provave dhe argumentave të palëve, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik në e-mail-in e datës 12.10.2021, konfirmuar dhe gjatë seancës dëgjimore, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Refuzimi i dhënies së informacionit mbi bazën e nenit 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është i gabuar, pasi, sipas qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik, aksesit në informacionin e disponuar nga autoritetet tatimore i'u legjitimohet vetëm institucioneve të përmendura në

të, duke përjashtuar *a priori* çdo individ që kërkon akses sipas dispozitave të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Dispozita në fjalë parashikon autoritetet të cilëve i'u ofrohet pa pagesë informacioni tatimor në lidhje me një tatimpagues të caktuar, por nuk parashikon ndalimin e dhënies së informacionit tatimor për subjekte të tjera mbi bazën e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Qëllimi i nenit 24 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk është përjashtimi i subjekteve të papërmendura në të nga aksesit në informacionin e administruar nga administrata tatimore, por thjeshtimi i marrëdhënieve dhe komunikimit midis administratës tatimore me këto institucione, eficaenca dhe deburokratizimi i administratës publike. Gjithashtu parashikimet e nenit 24 janë të zbatueshme dhe për ato raste kur informacioni nuk përbën informacion publik në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe dhënia e tij kryhet në një kontekst të caktuar siç është rasti i një procesi gjyqësor civil apo penal, kontrolli i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në kuadër të veprimtarisë së tij, etj.

Kërkesa për informacion, në rastin konkret, lidhet me detyrime që ligji ka përcaktuar të mblydhen për llogari të shtetit shqiptar nga Autoriteti Publik, detyrime këto që duhet të derdhen në buxhetin e shtetit dhe rrjedhimisht përbëjnë një interes për publikun.

Ndërkohë, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij gjithashtu përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit Publik, nuk rezulton të jetë argumentuar refuzimi i kërkesës në përputhje me këtë nen.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Ligji për të drejtën e informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Nga praktikata e administruara nga Komisioneri, konstatohet se qëndrimi i mësipërm është i përsëritur nga administrata tatimore edhe pse Komisioneri për të Drejtën e Informimit

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është shprehur më parë me vendime për raste të ngjashme ndaj këtij Autoriteti Publik.

Sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ si dhe deklarimit në seancën dëgjimore, Komisioneri konstaton se, nëpunësi që ka trajtuar kërkesën për informacion është znj. _____, me detyrë Specialiste Komunikimi, pranë Autoritetit Publik. Duke vepruar në këtë mënyrë, ka marrë përsipër ushtrimin kompetencave të koordinatorit *ad hoc* për të drejtën e informimit, duke marrë dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ky rol. Për këto arsye, kjo nëpunëse cilësohet si personi përgjegjës për mosvënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 18, pika 2, shkronja a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 2 dhe 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së znj. _____, nr. 1727 Prot., datë 15.10.2021, ndaj Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 12.10.2021, konkretisht:
 - *Detyrimet e shlyera dhe të pa shlyera ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nga ana e kompanisë Bankers Petroleum që nga viti 2004, brenda datës 11 . 11 .2021.*
3. Dënimin e znj. _____, me detyrë Specialiste Komunikimi në Autoritetin Publik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet

nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 04 . 11 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

